



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
DURRËS

**RAPORTI VJETOR I PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË DURRËS**

VITI 2016

Mars 2017

HYRJE

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", urdhërit Nr. 330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, "Për përmbajtjen e Raportit Vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë", paraqes përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Raportin Vjetor të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me juridiksion të përgjithshëm mbi ecurinë, treguesit e punës dhe gjendjen e kriminalitetit për vitin 2016.

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm!

Para së gjithash dëshiroj t'ju falenderoj për angazhimin e treguar nga ana Juaj dhe mbështjeten e vazhdueshme Tuajën dhënë Prokurorisë Durrës duke motivuar trupën e gjithë prokurorisë që të jenë më të përkushtuar dhe të vendosur në punën e tyre që ka të bëjë kryesisht në luftën kundër krimit dhe paligjshmërisë në territorin ku kjo prokurori është kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale. Duke e konsideruar mbështetjen Tuaj ndaj nesh si shprehje të vlerësimit të punës së Prokurorisë Durrës dhe përpjekjeve të përbashkëta në luftën kundër krimit dhe shkeljeve të tjera të ligjit dhe në mënyrë të veçantë në hetimin dhe gjykimin e veprave penale në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal.

Më lejoni z. Prokuror i Përgjithshëm, të paraqes në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës, progresin, përballjen me vështirësitë, zgjidhjet e dhëna dhe hapat e hedhura drejt zhvillimit dhe përmirësimit të standarteve dhe performancës së trupës së Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nëpërmjet Raportit Vjetor të saj, do të pasqyrojë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar të gjithë treguesit lidhur me veprimtarinë e punës së saj për periudhën një-vjeçare. Ky informacion përmban të dhëna mbi treguesit e punës vjetore, numrin e çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, numrin e çështjeve të regjistruara, mënyrën e zgjidhjes ligjore të tyre etj.

Nisur nga analiza e treguesve të veprimtarisë së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mund të themi se viti 2016 evidenton progres në rritje, në ushtrimin e përgjegjësi kushtetuese e ligjore. Falë angazhimit të Prokurorëve në ushtrim të funksioneve dhe detyrave të tyre, në veprimtarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës vihet re rritje e performancës së trupës së prokurorëve në përballimin e volumit të punës, cilësisë së hetimit, të efektivitetit dhe ligjshmërisë në ndjekjen penale, ngritjen e akuzës në gjykatë në emër të shtetit, ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikqyrjen e vuajtjes së dënimit, si dhe në ushtrimin e funksioneve të tjera të ngarkuara me ligj.

Evidentohet progres krahasuar me vitet paraardhëse si dhe arritje në efektivitetin e ndjekjes penale kundër krimit për të cilat Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është kompetente për hetimin dhe ndjekjen e tyre. Pavarësisht nga të

dhënat që do të prezantohen, jemi të vetëdijshëm se duhet të merren masa të tjera të domosdoshme për të garantuar rritjen e suksesit në luftën kundër krimit, duke kërkuar mbështetje dhe në strukturat e tjera ligjzbatuese të shtetit.

Mënyra më sintetike e përshkrimit të punës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës në ushtrimin e funksioneve të saj është gjuha e shifrave, prandaj më lejoni t'ju paraqes të grupuara treguesit e punës për periudhën një-vjeçare, shtrirjen dhe tendencat e kriminalitetit.

PËRMBAJTJA

I. Drejtimit dhe Përparësitë në Luftën Kundër Kriminalitetit për Vitin 2016.....	5
1. Lufta Kundër Korrupsionit.....	5
2. Respektimi i të Drejtave të Njeriut	6
3. Të Miturit dhe Grupet Vunerabël, si të Pandehur dhe Viktimat.....	7
4. Bashkëpunimi Ndërinstitucional.....	7
5. Bashkëpunimi Ndërkombëtar	8
6. Përdorimi i Metodave Speciale Hetimore dhe Hetimet Proaktive	8
7. Informacion mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të Nxjerra në Bazë të Tyre	8
8. Informacion Statistikor mbi Çështjet Penale që Lidhen me Procesin e Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike	9
9. Prioritetet e Prokurorisë Gjatë Vitit 2016.....	9
10. Problematikat e Hasura.....	10
II. Analiza e Treguesve të Kriminalitetit dhe Punës së Prokurorisë.....	12
1. Volumi i Punës në Hetim.....	12
2. Çështje të Përfaqësuara në Gjykatë	13
3. Treguesit Kryesor të Punës së Prokurorisë	14
4. Të Dhëna në Lidhje me Njoftimet për Veprat Penale.....	17
5. Të Dhënat në Lidhje me Masat e Sigurimit Personal e Pasuror	17
6. Treguesit e Ekzekutimeve të Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë.....	18
7. Kriminaliteti Sipas Peshës/Përhapjes së Veprave Penale dhe Tendencat e Tyre	20
8. Kriminaliteti Sipas Strukturës së Kodit Penal	22
III. Treguesit Statistikorë 2-Vjeçar të Veprave Penale Sipas Strukturës së Kodit Penal	26
IV. Analiza e Treguesve të Efektivitetit të Punës së Prokurorisë	54
1. Treguesit e Efektivitetit në Gjykim dhe në Dënimin e të Pandehurve.....	54
2. Të Dhëna Për Gjykimet e Posaçme	56
3. Të Dhënat mbi Llojet dhe Masat e Dënimeve.....	57
4. Të Dhëna Sociale dhe Demografike për të Pandehurit	59
5. Të Dhënat për të Pandehurit e Mitur	61
6. Të Dhënat për Pasojat e Veprave Penale	63
V. Të Dhënat Lidhur me Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja	64
VI. Të Dhënat për Ngarkesën e Punës për Çdo Prokuror dhe Oficer të Policisë Gjyqësore.	66
VII. Informacion mbi Administrimin e Prokurorisë.....	69
VIII. Drejtimit dhe Përparësitë në Luftën Kundër Kriminalitetit për Vitin Pasardhës dhe Rekomandime	70

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2016

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës gjatë vitit 2016 është fokusuar në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë duke patur në fokus të saj ndëshkimin e veprave penale të korrupsionit, krimit dhe fenomeneve të tjera në shkelje të ligjit. Qëllimi i gjithë trupës së prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës për vitin 2016 ka qenë rritja e standarteve të hetimit të procedimeve penale si dhe mbrojtja e akuzës në gjykatë duke kërkuar forcimin e profesionalizmit dhe integritetit të trupës së prokurorëve. Drejtimi dhe përparësitë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës në luftën kundër kriminalitetit kanë qenë të fokusuar kryesisht:

1. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës ka patur si prioritet të saj gjatë vitit 2016 hetimin e veprave penale të korrupsionit që lidhen me atë kategori veprash për të cilat kjo prokurori është kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale. Veprat penale kundër korrupsionit janë hetuar nga Njësia e Përbashkët hetimore task force në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës. Gjatë vitit 2016 prokurorët e kësaj njësie kanë hetuar një sërë veprash penale, ku objekt i tyre ka qenë korrupsioni, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2016 numri i procedimeve për veprat e korrupsionit të regjistruara ka qenë 10, krahasuar me një vit më parë vërehet një ulje në masën 23,07%. Lidhur me të pandehurit për këtë vepër penale rezulton se kemi 13 të pandehur, krahasuar me një vit më parë vërehet një rritje në masën 87,71%. Gjatë vitit 2016 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës ka ndjekur një politikë të ashpër penale për të pandehurit për të cilët është provuar se kanë kryer veprat penale të korrupsionit.

Rol kryesor në hetimin e këtyre veprave penale ka Njësia e Përbashkët Hetimore e cila gjatë këtij viti ka vazhduar përpjekjet e saj për të forcuar dhe konsoliduar më tej bashkëpunimin me strukturat e specializuara në ushtrimin e ndjekjes penale, në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe krimit kibernetik. Njësia e përbashkët hetimore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës për vitin 2016 është përpjekur për të qenë efiçente për hetimin e krimit të korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave etj.

Me gjithë vlerësimin e mirë që duhet bërë për prokurorët e Njesisë së Përbashkët Hetimore për vitin 2016, në kuadrin e hetimit të këtyre veprave penale, vlen për t'u theksuar fakti për punën e dobët të tyre në hetimin e veprës penale të "Pastrimit të Produkteve të Veprës Penale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Si rezultat i punës së dobët të Prokurorëve, Of.Pol.Gjyqësore dhe koordinimit me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit dhe për vitin 2016 nuk është arritur të përmirësohet puna dhe treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër. Nga të dhënat

statistikore rezulton se për vitin 2016 janë regjistruar 22 procedime penale krahasuar me një vit më parë kemi një ulje në masën 8%.

Ndjekja penale ndaj autorëve të veprës penale parashikuar nga neni 287 i K.Penal si dhe vepra të tjera penale në këtë fushë vazhdojnë të jenë prioritet i punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2016 janë regjistruar nga Njësia e Përbashkët Hetimore procedimet penale të ardhura nga burimet si vijon:

- 7 procedime penale kanë filluar kryesisht nga prokurorët e Njesisë së Përbashkët Hetimore
- 100 procedime penale mbi bazën e referimeve të ardhura nga Policia e Shtetit
- 1 procedim penal i referuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit
- 5 procedime penale nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
- 26 procedime penale nga Organet Tatimore dhe Doganore
- 99 procedime penale nga shtetas dhe nëpunës të tjerë publikë

Prioritet tjetër i punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës për vitin 2016 ka qenë dhe hetimi i veprave penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, krimeve kundër jetës të kryera me dashje, veprave penale që lidhen me taksat dhe tatimet, veprat penale të vjedhjes së pasurisë, veprat penale të ndërtimit të paligjshëm, vepra penale e drejtimit të parregullt të automjetit, vepra penale e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, krimi kibernetik etj.

2. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Prokuroria është e angazhuar maksimalisht për të bërë mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të pronës private dhe shtetërore, verpimtaria kriminale dhe e kundraligjshme, në këtë kuadër Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka forcuar bashkëpunimin me agjencitë e tjera ligjzbatuese me qëllim hetimin e plotë të veprave penale në këtë fushë. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në çdo rast të punës së saj është udhëhequr nga inspektimi i të drejtave të ligjshme të shtetasve duke mbrojtur liritë themelore të tyre, duke ju përmbajtur në çdo rast garantimit për një proces të rregullt dhe ligjor. Gjithashtu është mbajtur parasysh në hetimet paraprake në mënyrë të veçantë zbatimimi i kushteve dhe kritereve ligjore që kanë të bëjnë nga parimi i ligjshmërisë. Duke bërë të mundur zbatimin e kushteve dhe kritereve ligjore për caktimin e masës dhe sigurimit dhe të dënimit etj. Një kujdes i veçantë në këtë aspekt është mbajtur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në kërkesat e saj për të pandehurit e mitur dhe të pandehurat femra ku në shumicën e rasteve lidhur dhe nga rrezikshmëria shoqërore e tyre nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë kërkuar masa sigurimi më të buta nga ajo e arrestit me burg si dhe dënime alternative. Qëllimi i vetëm i këtij qëndrimi të mbajtur nga ana e Prokurorisë është riintegrimi në shoqëri i kësaj kategorie të pandehurish.

3. TË MITURIT DHE GRUPET VUNERABËL, SI TË PANDEHUR DHE VIKTIMAT

Mbrojtja e të drejtave të të miturve ne procesin penal ka qenë në fokusin e punës së organit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës gjatë vitit 2016 duke respektuar me rigorozitet urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm "Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur person në hetim, i dëmtuar ose dëshmitar" në të gjitha rastet nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është siguruar pjesëmarrja e psikologut gjatë hetimit si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore lidhur me provat e mbledhura për hetimin në ngarkim të të pandehurve të mitur. Në çdo rast prokurori i seksionit për hetimin e krimit të kryer nga të miturit ka njoftuar pa vonesë prindërit ose përfaqësuesit ligjorë të tyre duke ju përmbajtur kësisoj parimit më të lartë të interesit të të miturit. Lidhur me caktimin e dënimit të të pandehurve të mitur nga mosha 14 deri 18 vjeç për vitin 2016 rezulton se për 55 të pandehur është kërkuar caktimi i dënimeve alternative dhe kryesisht është kërkuar pezullimi i dënimit me burgim dhe vënie e të pandehurit në provë. Po ashtu rol të veçantë dhe prioritet kanë patur hetimi i veprave penale të kryera ndaj fëmijëve, martesës dhe familjes.

4. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2016 ka patur dhe mbartur marrëdhënie korrekte dhe pozitive me institucionet e tjera, të cilat janë të përfshira dhe të lidhura me punën tonë. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

**Prokurorinë e Përgjithshme
Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës,
Prokurorinë e Apelit Durrës
Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës
Institucione të tjera në nivel lokal**

-Në raport me Prokurorinë e Përgjithshme, gjatë vitit 2016 është vërejtur një raport shumë i ngushtë bashkëpunimi i cili konsiston në gadishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë nga të gjitha drejtoritë pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

-Raportet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, gjatë vitit 2016 kanë qenë korrekte dhe ligjore duke u bazuar në korrektesën e ndërsjelltë dhe reciproke. Vlerësojmë impenjimin e trupës gjyqësore (dhoma penale) për trajtimin e problematikave të veçanta të evidentuara për disa çështje.

-Raportet me Prokurorinë e Apelit Durrës, vazhdojnë të jenë raporte reciproke dhe të ndërsjellta duke mbajtur kontakte të vazhdueshme në funksion të përfaqësimit të akuzës lidhur me çështjet penale të ankimuar nga Prokurorët Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Pavarësisht marrëdhënieve korrekte që kemi me Prokurorinë e Apelit Durrës vlen për t'u theksuar fakti që në disa raste nga prokurorët e Apelit nuk është bërë përkrahja e ankimit të ushtruar nga Prokurorët e

Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, raste të cilat janë përfaqësuar nga vetë prokurorët që kanë ushtruar ankimin ndaj vendimit të Gjykatës, ku në disa raste Gjykata e Apelit ka vendosur sipas kërkesës së Prokurorit i cili ka ushtruar ankimin.

-Raporti me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, vazhdon të jetë një raport bashkëpunimi ndërinstitucional në angazhim të përbashkët për hetimin e krimit, duke patur në fokus të këtij bashkëpunimi Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm. Pavarësisht marrëdhënieve të mira bashkëpunuese konstatohet se ka zvarritje të afateve të hetimit të procedimeve penale nga ana e Of.Pol.Gjyqësore të ngarkuar me hetimin dhe shkak kryesor i këtyre zvarritjeve rezulton të jetë transferimi i Oficerëve të Policisë Gjyqësore në kohë të shkurtër dhe në këtë drejtim nuk është mbajtur parasysh Urdhëri i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm për Policinë Gjyqësore.

-Raporti me institucionet e tjera vazhdon të jetë një raport korrekt, institucional dhe i ndësjelltë me Organet e Qeverisjes Vendore etj.

5. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka pasur komunikimin e saj me Drejtorinë e Mardhëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme si hallka kryesore për marrëdhëniet ndërkombëtare të Prokurorisë. Në këtë kuadër nëpërmjet kësaj Drejtorie nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë kërkuar një sërë veprimesh procedurale që duhet të kryheshin nga autoritetet gjyqësore ndërkombëtare.

6. PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE HETIMORE DHE HETIMET PROAKTIVE

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për vitin 2016 para ndryshimeve ligjore, ka kryer funksionin e saj Njësia e Përbashkët Hetimore, Task-Force, ku objektiv kryesor i punës së kësaj njësie ka qenë goditja e veprave penale të korrupsionit dhe veprave penale në kompetencë të kësaj njësie të kryera në fushën e ekonomisë, ku në disa raste të hetimit të këtyre veprave janë përdorur metoda speciale të hetimit siç janë ato të përgjimeve, vëzhgimeve etj. Këto raste kanë qenë rezultative dhe në disa raste për shkak të aplikimit të këtyre metodave është proceduar me arrestin në flagrancë të autorëve të këtyre veprave penale.

7. INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË NXJERRA NË BAZË TË TYRE

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është angazhuar dhe ka punuar në drejtim për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në lidhje me prioritetet në hetimin e veprave penale për të cilat nga Këshilli i Ministrave ka

pasur rekomandime përkatëse duke unifikuar zbatimin e këtyre rekomandimeve me urdhërat dhe udhëzimet e dala nga Prokurori i Përgjithshëm.

8. INFORMACION STATISTIKOR MBI ÇËSHTJET PENALE QË LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TË INTEGRIMIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

Lidhur me hetimin e veprave penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike rezultojnë që për vitin 2016 është regjistruar një procedim penal mbi bazën materialeve të përcjella nga Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

9. PRIORITETET E PROKURORISË GJATË VITIT 2016

Prioriteti i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2016 ka qenë dhe rritja e përgjegjësisë në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe respektimit të dinjitetit, privatësisë, sigurisë personale të personave të dëmtuar nga veprat penale, ku në të gjitha rastet prokurori i ka njohur me të drejtën që ato kanë në procesin penal. Në kuadër të ndryshimeve ligjore Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me qëllim sigurimin e të drejtave të kësaj shtrese duke bashkëpunuar ngushtë dhe me zyrën e ndihmësit e viktimave pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të ushtrojë funksionin për mbrojtjen e të drejtave të kësaj shtrese nëpërmjet koordinatorit, me qëllim sigurimin e informimit, këshillimit të viktimave të krimit me fokus të veçantë viktimat në moshë të mitur, me aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës në familje, shfrytëzimit seksual etj.

Një vëmendje të veçantë Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka kushtuar dhe aksesit të publikut për informacion, në këtë pikë është zbatuar me rigorozitet dispozita ligjore për të drejtën e informimit, ku në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2016 është caktuar një prokuror për të informuar të gjithë ata që kanë shprehur interes për të marrë informacion lidhur me punën e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, veprim ky i koordinuar edhe me strukturat eprore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Gjithashtu gjatë vitit 2016 është mbajtur në vëmendje dhe forcimi i kontrollit të brendshëm të prokurorisë si dhe vendimmarrja e drejtuesit të prokurorisë, gjë e cila ka konsistuar në kontrollin e veprimtarisë së hetimit të ushtruar nga ana e trupës së prokurorëve, nxjerrja e problematikave, urdhërave dhe udhëzimeve dhe detyrat konkrete të lëna për çdo prokuror për çështje konkrete. Nga ana e drejtuesit të prokurorisë janë kontrolluar dhe shqyrtuar të gjithë procedimet penale që kanë të bëjnë me vendimet e dërgimit të çështjes në gjyq, vendimin e pushimit, mosfillimit etj. Ku në të gjitha rastet është vepruar me vendim për shfuqizimin e atyre vendimeve për të cilat është konstatuar dhe menduar se vendimmarrja e prokurorit nuk ka qenë e drejtë.

Një ndër pikat lidhur me prioritetet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka qenë kërkesa ndaj trupës së prokurorëve për të respektuar me rigorozitet

kodin e etikës. Gjatë vitit 2016 ka rezultuar se nga gjithë trupa e prokurorëve, of.pol.gjyqësore dhe administratës në përgjithësi është respektuar kodi i etikës.

Trupa e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në mënyrë vazhduese gjatë vitit 2016 ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës si dhe në trajnime të organizuara nga OPDAT, PAMECA, EURALIUS etj.

10. PROBLEMATIKAT E HASURA

Lidhur nga sa u parashtua në pikat më lart mbi drejtimin dhe përparësinë në luftën kundër kriminalitetit nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë vërejtur problematika të hasura dhe kryesisht lidhur me metodat speciale hetimore dhe hetimet proaktive duke marë shkas nga referimi i paktë i veprave penale në fushën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik nga të gjithë faktorët të përcaktuar në memorandumun e bashkëpunimit për funksionimin e njësive të përbashkëta hetimore (Task-Force).

Përsa i përket fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike, i cili në krahasim me vitet paraardhëse ka patur rritje të numrit të veprave penale për këtë rast, duhet theksuar fakti se zbulueshmëria është në kufijtë minimal, pothuajse nuk ka të identifikuar persona të cilët financojnë dhe organizojnë këtë veprimtari, për autorët dhe për goditjen e këtij fenomeni. Për këtë konstatohet përhapja e kësaj vepre penale në të gjithë territorin e rrethit tonë si dhe të përfshirjes në kryerjen e kësaj vepre penale të personave me gjendje ekonomike të vështirë të cilët janë kthyer në ndihmës të strukturave kriminale të cilët meren me kultivimin e bimëve narkotike. Nga ana e policisë nuk është bërë e mundur që të referohen në Prokurori materiale hetimore për persona konkret që mund të jenë organizatorë, financues dhe të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Si rrjedhojë dhe puna hetimore për zbulimin dhe identifikimin e autorëve të kësaj vepre penale nuk ka dhënë rezultate për këtë fenomen.

Po ashtu gjatë vitit 2016 një ndër problematikat kryesore dhe shqetësuese ka qenë tejkalimi i afateve në hetimin e veprave penale si dhe cilësia e hetimit si në përpilimin e akteve ashtu dhe në mbledhjen e provave nga ana e trupës së prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, pasi në këtë drejtim është vërejtur një problematikë jo pak e rëndësishme në vendimmarrjen e prokurorëve ka qenë mosbërja në kohë e akteve të ekspertimit nga ana e Policisë Shkencore dhe ekspertëve të fushave të ndryshme, gjë e cila ka çuar në zvarritjen e afateve të hetimit përtej përcaktimeve ligjore, gjithashtu problematikë serioze gjatë këtij viti është hasur dhe në përpilimin e akteve procedurale nga Policia Gjyqësore si e seksionit të Prokurorisë ashtu dhe të shërbimeve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Durrës, problematika kryesore qëndron në referimin jo të saktë të veprës penale, marrjes së provave, gjeneraliteteve të subjekteve, mosnjoftimin e prokurorit për ngjarjet e ndodhura etj, veprime të cilat kanë sjellë cilësi të dobët të hetimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal duke e vendosur kështu prokurorin

në vështirësi në zgjidhjen në kohë të çështjes penale si dhe kualifikimit të drejtë të veprës penale. Mosprofesionalizmi në hetim ka sjellë dhe dhënien e pafajësive nga ana e gjykatës për disa çështje penale të cilat kanë qenë objekt i diskutimeve dhe të nxjerrjes së konkluzioneve dhe përgjegjësive përkatëse.

Lëvizja e shpeshtë e O.P.Gjyqësore të D.V.P.Qarkut Durrës pa marrë më parë miratimin e prokurorit sipas marrveshjes së përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm është një problematikë tjetër e hasur në hetimin në kohë të veprave penale dhe cilësisë së hetimit. Vërehet një cilësi e dobët profesionale e personelit të enteve shtetërore me të cilët Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka marrëdhënie pune në shkëmbimin e informacionit, marrjen e të dhënave dhe përpilimit të akteve për çështje të veçanta siç janë Prefektura, Bashkia, zyra e Regjistrimit të Pronave, Agjensia e Legalizimeve, etj. Gjithashtu një problematikë tjetër jo pak e rëndësishme është hasur në lidhje me kryerjen e ekspertizave kryesisht të atyre në fushën e aksidenteve rrugore dhe në punë për shkak të mungesës së akteve nënligjore në lidhje me kompetencën profesionale (liçensimi i tyre) në këtë drejtim mendoj se duhet patjetër që për këtë problem të ngrihet një sektor ekspertize pranë Prokurorisë duke rekrutuar ekspertë të liçensuar në fushat përkatëse.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITATIT DHE PUNËS SË PROKURORISË


1. VOLUMI I PUNËS NË HETIM

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2016 ka trajtuar në total **4144** materiale kallëzuese, regjistrimet e reja për vitin 2016 janë **3584** materiale kallëzuese, gjatë trajtimit të këtyre materialeve është konkluduar dhe më pas është vendosur regjistrimi i procedimeve penale për **2222** materiale kallëzuese/referuese dhe është vendosur mosfillimi për **1359** materiale kallëzuese/referuese. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2016 ka ndjekur në hetim **2782** procedime penale dhe **3** procedime penale ushtarake, me **1730** të pandehur, nga të cilët **606** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”. Nga këto, janë regjistruar **2222** procedime penale të reja, me **1361** të pandehur, prej të cilëve **527** persona me masë sigurimi “Arrest në burg”, **449** procedime penale janë mbartur, **71** procedime penale janë rifilluar dhe 40 procedime penale kanë ardhur me transferim nga prokuroritë e tjera.

Krahasuar me vitin 2015 rezulton se kemi një ulje prej 11,52% të materialeve hetimore kallëzuese/referuese për të cilat trupa e prokurorëve ka vendosur mosfillimin e procedimeve penale. Gjithashtu konstatohet se kemi ulje në masën 6,67% të regjistrimeve për procedimet penale krahasuar me vitin 2015.

Më poshtë, në tabelë paraqitja krahasuese e viteve 2015-2016 evidenton treguesit e procedimeve penale të ndjekura, përfshi dhe procedimet penale të mbartura nga viti 2015, të regjistruara, të ardhura me transferim dhe të rifilluara në vitin 2016.

Vitet	Proc.Mbartura	Proc.Rregjistruara	Proc.Rifilluara	Proc. Ardhura me Transf.	Proc.Ndjekje Penale
2015	451	2381	105	40	3254
2016	449	2222	71	40	2782
Krahasimi	Ulur 0,4%	Ulur 6,67%	Ulur 32,38%	I Njëjtë	Ulur 14,5%




Evidentohet tendenca në ulje e numrit të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

Në vitin 2016 janë përfunduar hetimet për **2328** procedime penale dhe 3 procedime për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak, me **1198** të pandehur dhe 1 person i pandehur për veprat penale ushtarake dhe **281** persona nën hetim, që zënë **83,68%** të procedimeve penale të ndjekura ose **15,55%** procedime penale të përfunduara më pak se viti 2015.

2. ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË


Gjatë vitit 2016 nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 1043 procedime penale dhe 1 procedim penal për veprat penale ushtarake, një ulje prej 18,18% në krahasim me vitin 2015, me 1187 të pandehur dhe 1 person i pandehur për veprat penale ushtarake, përkundrajt 1408 të pandehurve në vitin 2015, një ulje prej 15,62% në krahasim me vitin 2015. Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 593 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal. Këto të dhëna paraqiten grafikisht në grafikun e mëposhtëm:



3. TREGUESIT KRYESOR TË PUNËS SË PROKURORISË

Më poshtë tabela evidenton treguesit e procedimeve penale dhe të pandehurve sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake, krahasuar me vitet 2015-2016.

Vitet	Gjyqit		Pushuara		Pezulluara		Përfunduara	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur + Persona nën hetim	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2015	1276	1408	474	277	1002	1	2803	1708
2016	1043	1187	370	242	852	2	2328	1198
Krahasoni	Ulur 18,26%	Ulur 15,69%	Ulur 21,94%	Ulur 12,63%	Ulur 14,97%	Rritur 100%	Ulur 16,94%	Ulur 29,85%



Sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton kjo gjendje:

Është ngritur akuzë në gjykatë për **1043** procedime penale, me **1187** të pandehur prej të cilëve **516** persona me masë sigurimi “Arrest në Burg”. Krahasuar me vitin 2015 kemi një ulje prej 18,26% të procedimeve dhe 15,69% të pandehurve. Në ndjekjen penale në hetim evidentohen se janë dërguar në gjykatë 44,78% e procedimeve të përfunduara ose është ngritur akuzë për 80,27% të të pandehurve ndaj të cilëve janë përfunduar hetimet.

Janë pushuar **370** procedime penale me **242** persona si të pandehur dhe persona nën hetim që zënë 15,91% të procedimeve penale të përfunduara.

Krahasuar me vitin 2015 kemi një ulje prej 21,61% të procedimeve penale të pushuara. Si rezultat i punës së përbashkët të prokurorisë me strukturat e policisë gjyqësore të Policisë së Komisarariatit Durrës janë rifilluar hetimet për **71** procedime të pezulluara, si rezultat i zbulimit të autorit apo të dhënave të tjera të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve. Po ashtu rezulton se për vitin 2016 Prokurorët kanë ndërmarrë pushimin për **490** procedime penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Për të minimizuar këto raste është tërhequr vëmendja e të gjithë trupës së prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në mënyrë të vazhdueshme që të bëjnë kujdesin maksimal kur të operojnë me vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj shtetasve veçanërisht me masën e sigurimit “Arrest në burg”, në mënyrë që kërkesa për vendosjen e kësaj mase të mos çënojë padrejtësisht

liritë e shtetasve dhe të mos shndërrohet në një mjet shantazhimi ndaj tyre. Sipas shkaqeve ligjore mbi të cilët është vendosur pushimi i çështjeve evidentohet se:

Pezullimi i hetimeve është vendosur për **852** procedime penale, që zënë 36,59% të procedimeve penale të përfunduara dhe krahasuar me vitin 2015 kemi një ulje me 14,87%. Të ndarë sipas shkaqeve ligjore për të cilët është vendosur pezullimi gjendja paraqitet:

Për shkak se autori i veprës penale nuk njihet janë pezulluar hetimet dhe vazhdon gjurmimi nga policia për zbulimin e autorëve për **851** procedime penale që zënë 99.9% të çështjeve të pezulluara.

Ndërsa, për shkak se të pandehurit kanë vuajtur nga një sëmundje e rëndë kemi pezulluar vetëm **2** procedime penale.

Me zgjatje afati janë ndjekur **195** procedime, që zënë rreth 7% të procedimeve penale të hetuara, krahasuar kjo me një vit më parë kemi një ulje prej 33,89%.

Janë **mbartur** për vitin 2017 në fazën e hetimeve paraprake **454** Procedime Penale, me **115** të pandehur dhe 136 persona nën hetim, prej të cilëve **76** persona me masë sigurimi "Arrest në burg", pra rreth 16,3% e numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2016, krahasuar me vitin 2015 janë mbartur 0,6% procedime më shumë.

Mosfillimet

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit/kallëzimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme.

Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementet e veprës penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës ka pësuar ulje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar, pasi rezulton se për vitin 2015 është vendosur mosfillim për **1536** materiale, ndërsa në vitin 2016 është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit për **1359** kallëzime apo referime të veprës penale në Prokurori për "Rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit", nenet 290 e 291 të K.Pr.Penale.

Krahasuar me vitin 2015 kemi një ulje me 11,52%. Në uljen e procedimeve të mosfilluara kanë ndikuar dhe materialet referuese të ardhura nga shërbimet e policisë gjyqësore me sugjerimin për vlerësim.

Në lidhje më çështjet e përfunduara nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit janë prishur 2 vendime të Prokurorëve.

Veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak

Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak për vitin 2016 janë mbartur 3 procedime nga të cilat 1 procedim penal është pezulluar, 1 procedim penal është pushuar dhe 1 procedim penal është dërguar për gjykim me 1 të pandehur.

4. TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat e regjistrit të njoftimeve/kallëzimeve të veprave penale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton se në vitin 2016 janë **filluar kryesisht** 16 procedime penale nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: Në vitin 2016 rezulton të jenë 87 kallëzime.

Kallëzime nga shtetasit: Në vitin 2016 rezultojnë 280 kallëzime të bëra nga shtetasit.

Gjithashtu, theksojmë se gjatë vitit 2016 janë marrë **3201 referime nga Policia e Shtetit**.

5. TË DHËNAT NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT PERSONAL E PASUROR

Gjatë vitit 2016 janë arrestuar, ndaluar si dhe me urdhër ndalimi të Prokurorit **592** persona, nga të cilët:

- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest me Burg” për **547** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest me Burg” për **503** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest me Burg” në mungesë për **4** të pandehur, ku edhe Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest me Burg” në mungesë për **4** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në Shtëpi” për **2** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Arrest në Shtëpi” **11** të pandehur .
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Burg me Afat” për **1** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Burg me Afat” për **2** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Garanci Pasurore” për **6** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Garanci Pasurore” për **7** të pandehur.
- Prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje” për **46** të pandehur, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë masën e sigurimit “Detyrim për Paraqitje” për **80** të pandehur.

Njësia e përbashkët hetimore *Task Force* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vitin 2016 ka marrë vendim për sekuestro preventive në 8 raste, konkretisht ka vendosur masën e sekuestros përvetive për rastet e mëposhtme:

1. Për nenin 186 dhe 248 të Kodit Penal ka sekuestruar 45000 m², tokë shtet.
2. Për nenin 287 të Kodit Penal janë sekuestruar 250000 euro.
3. Për nenin 287 të Kodit Penal janë sekuestruar 15000 euro.
4. Për nenin 287 është sekuestruar:
 - truall 300 m²,
 - truall 560 m²,
 - nje hotel 7 katësh me 355 m²
 - 3 automjete.
5. Për nenin 181 të Kodit Penal janë sekuestruar 10 milionë lekë.
6. Për nenin 287 të Kodit Penal është sekuestruar nje sipërfaqe truall 600 m².
7. Për nenin 287 të Kodit Penal janë sekuestruar 225000 euro.
8. Për nenin 287 të Kodit Penal janë sekuestruar 5000 euro.

6. TREGUESIT E EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë vitit 2016, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre. Më konkretisht gjatë vitit 2016, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë për 572 të dënuar me burgim dhe për 234 me dënim më gjobë. Nga këto janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 384 vendime penale të evidentuar në tabelën e mëposhtme:

Llojet e dënimit	Urdhëruar ekzekutimi	Ekzekutuar	Të mbartura nga vitet e tjera pa u ekzekutuar	Të mbartura nga viti 2016 pa u ekzekutuar	Ngelen për t'u ekzekutuar
Burg	572	318	408	26	430
Gjobë	234	22	573	86	625
Dënim plotësues	21	10	42	7	46
Dënime alternative	504	34	1048	241	1286
Gjithsej 2016	1331	384	2070	360	2387

Së bashku me vendimet e mbartura nga vitet e kaluara ngelen për t'u ekzekutuar dhe 2387 vendime gjyqësore të formës së prerë, nga të cilat 430 me burgim (persona në kërkim) dhe 625 dënime me gjobë.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka kushtuar një vëmendje problemit të ekzekutimit të vendimeve penale gjyqësore të formës së prerë, duke zbatuar dispozitat dhe kërkesat ligjore të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale". Në të gjitha rastet prokurori i

ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë ka nxjerrë urdhërat e ekzekutimit pasi i janë vënë në dispozicion vendimet penale të formës së prerë nga gjykata, por ka raste dhe kur këto vendime janë tërhequr kryesisht nga prokurori. Urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë brenda afateve ligjore dhe u janë dërguar për zbatim organeve të Policisë për masat sigurimit, I.E.V. Penale për dënimet me burgim dhe Zyres Përmbartimore për dënimet me gjobë.

Krahas ekzekutimit të vendimeve penale të gjykatës prokurorët kanë marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të veçanta të të dënuarve, për aplikimin e lirimit me kusht, qëndrim në shtëpi dhe lirimit për shkak sëmundje. Gjatë vitit 2016 janë shqyrtuar gjithsej 88 kërkesa, kryesisht nga të dënuarit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, prej të cilave 5 të mbartura nga viti 2015. Kërkesat e të dënuarve kanë qenë: 70 kërkesa për aplikimin e nenit 64 të K.Penal, 13 kërkesa për aplikimin e nenit 59/a të K.Penal dhe 5 kërkesa për nenin 478 të K.Pr.Penale.

Për nenin 64 të Kodit Penal janë rrëzuar 20 kërkesa, pushuar 12 kërkesa, transferuar 8 kërkesa, pranuar 18 si dhe mbartur për vitin 2017 12 kërkesa. Sa i përket nenit 59/a të Kodit Penal janë rrëzuar 6 kërkesa, pranuar 4 kërkesa si dhe janë mbartur për vitin 2017 3 kërkesa. Për nenin 478 të Kodit Penal janë pushuar 2 kërkesa dhe rrëzuar 3 kërkesa.

Në periudhën analizuese janë përfunduar 70 kërkesa dhe 15 kërkesa janë mbartur për vitin 2017.

Për rritjen e efektivitetit të punës lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale është forcuar bashkëpunimi me organet e policisë, veçanërisht për personat e dënuar të shpallur në kërkim, ku çdo muaj analizohet ky problem duke rakorduar dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet e listës së personave në kërkim. Megjithë përmirësimet e bëra dhe të evidentuara përsëri vazhdon që të ketë vendime gjyqësore penale të formës së prerë të paekzekutuara.

Mbikqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në veçanti për vënien në ekzekutim të dënimeve me burgim si dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim mbetet një ndër drejtimitet e punës tonë me synim riedukimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri, duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën tonë me atë të Z.V.Sh.Provës. Në këtë drejtim mendoj se duhet të punohet për arritjen e një politike dënimi e cila duke marrë parasysh gjendjen e kriminalitetit në rrethin e Durrësit dhe specifikat psiko-sociale të shoqërisë, të mbështetet në parimin që nëpërmjet dënimeve gjyqësore të arrihet goditja e krimit dhe jo e shoqërisë.

Rezultatet e sipërpërmendura në treguesit kryesorë të aktivitetit të organit të Prokurorisë Durrës janë rrjedhojë e rritjes së përgjegjësisë për realizimin e detyrave nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, është forcimi i disiplinës në punë dhe i kërkesës së vazhdueshme për realizimin e objektivave dhe veprimeve procedurialo-penale. Në këtë drejtim analizat e vazhdueshme dhe ato herë pas here

me Prokurorët dhe oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore kanë rritur shpejtësinë në hetimet paraprake dhe u janë dhënë zgjidhje ligjore si kallëzimeve ashtu dhe procedimeve penale në hetim. Kjo ka bërë që muajt e fundit shumë pak procedime penale të hetohen me zgjatje afati, që besimi i qytetarëve tek organi i Prokurorisë të ketë ardhur në rritje, ndërsa ankesat dhe kërkesat e subjekteve të tjerë të procedimeve penale të jenë pothuajse në shifra të papërfillshme.

7. KRIMINALITETI SIPAS PESHËS/PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE DHE TENDENCAT E TYRE

Për vitin 2016 vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprat penale si më poshtë:

-“Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 24,24% e numrit të procedimeve të regjistruara për në krahasim me vitin 2015.

-“Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 20% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në krahasim me vitin 2015.

-“Krimet seksuale” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 36,36% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 5,68% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër lirisë së besimit” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 100% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale e shkatërrimit të pronës” rezulton se në vitin 2016 ka ulje në krahasim me vitin 2015, në masën 39% të numrit të procedimeve të regjistruara.

-“Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje me 50% të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 22,22% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Krime në fushën e doganave” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 64,47% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 52,5% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 28,57% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 4,87% të numrit të procedimeve të regjistruara për grup në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 70% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 6,77% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra Penale Kundër Mjedisit” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 22,22% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 10,97% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 8% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 4,16% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 100% të procedimeve në krahasim me vitin 2015.

-“Veprat penale të korrupsionit” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 23,07% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër krimit kompjuterik” rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 12,5% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Krimet kundër jetës shkaktuar me pakujdesi” rezulton se në vitin 2016 nuk ka ndryshim të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash në krahasim me vitin 2015.

Përsa i përket veprave penale të mëposhtme vihet re një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2016:

-“Vepra penale kundër lirisë së personit” rezulton se në vitin 2016 kemi një rritje prej 33,33% të procedimeve të regjistruara për në krahasim me vitin 2015.

-“Vjedhja e pasurisë” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 2,89% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 90,9% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Mashtrimet” rezulton një rritje prej 42,22% e numrit të procedimeve të regjistruara të vitit 2016 në krahasim me vitin 2015.

-“Vepra penale kundër drejtësisë” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 78,78% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Veprat penale të trafikeve të paligjshme” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 37,5% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje 4,3% të procedimeve të regjistruara për veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve në krahasim me vitin 2015.


-“Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 28,94% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

-“Krime kundër autoritetit të shtetit” rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 9% të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2015.

8. KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2016, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.



Për vitin 2016, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë

sipas vendimeve penale të parashikuara nga Kodi Penal, nga analiza e të dhënave statistikore rezulton se:

-Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2016 është 1,12%.

-Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera nga pakujdesia** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0.01%.

-Raporti që zënë **vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2016 është 2,07%.

-Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0%.

-Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë** ose mosdhënia e ndihmës në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,18%.

-Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,3%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,18%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,94%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 3,73%.

-Raporti që zënë **veprat penale te kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokuorori është në vitin 2016 është 0,04%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0%.

-Raporti që zënë **veprat penale të drejtimit të automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 11,54%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 41,63%.

-Raporti që zënë **mashttrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara ne prokurori në vitin 2016 është 2,88%.

-Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 1,75%.

-Raporti që zënë **veprat penale që çenojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 4,87%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,31%.

-Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtaritë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,31%.

-Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 1,21%.

-Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,85%.

-Raporti që zënë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,22%.

-Raporti që zënë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 3,51%.

-Raporti që zënë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,27%.

-Raporti që zënë **krimet kundër autoritetit të shtetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 2,16%.

-Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetëror ose në shërbimin publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 2,2%.

-Raporti që zënë **vepra kundër rendit dhe sigurisë publike** së personit në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 19,35%.

-Raporti që zënë **vepra kundër pastrimit të produkteve të veprës penale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 1,03%.

-Raporti që zënë **vepra kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 1,12%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 2,65%.

-Raporti që zënë **vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0%.

-Raporti që zënë **veprat penale kundër korrupsionit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,45%.

-Raporti që zënë **veprat penale të krimit kibernetik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 0,31%.

-Raporti që zënë **veprat penale të trafikeve të paligjshme** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 1,48%.

-Raporti që zënë **veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2016 është 4,37%.

III. TREGUESIT STATISTIKORË 2-VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Në tërësinë e veprave penale të regjistruara gjate vitit 2016 organi i prokurorisë është fokusuar në mënyrë të veçantë në disa çështje specifike për të cilat trupa e prokurorëve kanë qenë të përqëndruar në hetimin e tyre, të cilat janë:

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

“Krime kundër jetës të kryera me dashje” përbën një nga grupet e veprave penale që kërkojnë vemëndje maksimale, pasi lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 24,24% të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash në krahasim me vitin 2015.

Gjithsesi në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duhet theksuar se gjatë vitit 2016, në krahasim me vitin 2015, ka një ulje të procedimeve penale në veprën penale me të rëndësishme, të përfshirë në këtë grup, e cila është “vrasje në rrethana cilësuese”, ku konstatohet një ulje në masën 66,66% krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë, vërehet një ulje me 36,36% të procedimeve penale për veprën “vrasje me paramendim”.

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2016 është 1,12% e numrit total të procedimeve penale të regjistruara, ndërsa për vitin 2015 ky grup veprash përbënte 1,3% të totalit të procedimeve. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja	7	2	8	2	1	3	3	5	3	0
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	11	1	2	1	2	8	3	6	3	1
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	3	1	2	1	1	1	0	0	0	0
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	1	0	1	0	0	1	0	3	0	0

Neni 79/dh Vrasja kundër dy ose më shumë personave	2	1	1	1	1	1	0	0	0	1
Neni 80	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0
Neni 81 Vrasja e foshnjës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	9	2	5	2	0	9	4	7	3	1
Totali	33	7	19	7	5	25	11	24	10	3

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 24,24% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi një rritje prej 57,14% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 26,31%, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 42,85% dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40% përkundrejt vitit 2015.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprën penale të cilat parashikohen në Kreun “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	1	1	1	1	0	1	0	0	0	0
Totali	1	1	1	1	0	1	0	0	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 nuk ka rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi” në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi ulje të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015 nga 1 në 0 të tillë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë vepër penale, vihet re se numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 1 në 0. Nuk ka të pandehur të cilët i janë dërguar gjyqit.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2016 është 2,07 %, ndërsa për vitin 2015 ky grup veprash përbënte 3,65% të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 88 Plagosje e rëndë	10	8	9	8	4	5	4	11	4	1
Neni 88/b Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijev të mbrojtjes së nevojshme	0	0	0	0	0	3	2	3	2	0
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	77	43	102	59	10	38	15	47	22	11
Totali	87	51	111	67	14	46	21	61	28	12

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2016 në Prokurorinë e Rrethit Durrës ka një ulje prej 43,67% e numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2015. Po kështu tendencë në ulje prej 58,82% paraqet edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 45,04%, ulje e numrit të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,28% përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2016 është 0%, ku e njëjta gjë është edhe për vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nuk janë regjistruar procedime penale për vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,18%. Ky tregues për vitin 2015 ka qenë 0,2%, pra vihet re një ulje e lehtë e tij për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	3	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Totali	5	0	0	0	0	4	0	0	0	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 20% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës, në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015 është i njëjtë pra 0. E njëjta gjë vërehet edhe në lidhje me numrin e të pandehurve të regjistruar, numrin e të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata përkundrejt të njëjtëve tregues të vitit 2015.

KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2016 është 0,3%, ndërkohë që për vitin 2015 ka qenë 0,46%. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

KRIME SEKSUALE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	2	1	2	1	0	1	2	0	2	0
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	1	0	1	0	0	1	1	1	0	0
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura	3	0	2	0	0	3	0	3	0	0
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkçënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	5	2	4	2	0	2	1	1	1	1
Totali	11	3	9	3	0	7	4	5	3	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 36,36% të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2015. Kemi rritje prej 33,33% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 44,44%, numër i njëjtë i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe nuk kemi të pandehur të dënuar nga gjykata, e njëjta gjë si në vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2016 është 0,18% dhe për vitin 2015 ka qenë 0,12%. Pra vihet re tregues pothuajse i njëjtë për vitin 2016 dhe vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 109/a Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuse	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurisë	0	0	0	0	0	2	0	1	0	0
Neni 109/c Zhdukja me forcë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	3	2	2	2	0	2	2	3	3	0
Neni 111Rrëmbimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 112 Dhunimi i baneses	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	3	2	2	2	0	4	2	4	3	0

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 kemi një rritje prej 33,33% të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2015. Është i pandryshuar numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 100%, rritje me 50% të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit. Nuk ka të pandehur të dënuar nga gjykata.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,94% ndërsa për vitin 2015 ka qenë 0,46%. Pra, vihet re rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2015					2016				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykin	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 113 Prostitucioni	0	0	0	0	0	1	1	24	25	0
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	4	0	3	0	0	7	1	4	3	0
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	0	0	0	0	0	0	0	3	3	0
Neni 117 Pornografia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 118 Dhunimi i varreve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119 Fyerja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 120 Shpifja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 121 Ndërrhyrje të padrejta në jetën private	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 121/a Përndjekja	5	4	5	4	0	13	5	9	4	1
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Totali	11	5	10	5	0	21	7	40	35	1

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 90,9% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale

kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi rritje prej 40% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 300%, po kështu ka rritje edhe numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 600% dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100% përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Gjatë vitit 2016 konstatohet angazhim specifik i Prokurorisë së rrethit Durrës lidhur me evidentimin, hetimin dhe dënimin e “veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”. Gjithashtu, konstatohet rritje e ndjeshme e rasteve të referuara lidhur me këto vepra. Në vlerësimin e organit të Prokurorisë, kjo rritje është rrjedhojë e forcimit të besimit të publikut tek institucioni. Nga hetimet e pjesës më të madhe të rasteve, rezulton se viktimat kanë qenë në ushtrimin e dhunës për një kohë të gjatë dhe janë ndërgjegjësuar për raportimin e këtyre rasteve pranë organeve shtetërore. Gjithashtu, vlerësojmë se një rol pozitiv në shtimin e kallëzimeve për këtë vepër penale ka dhënë edhe media. Seria e gjatë e emisoneve dhe kronikave sensibilizuese lidhur me këtë temë ka ndikuar në bindjen e qytetarëve, viktimave të dhunës, të kërkojnë mbrojtjen e institucioneve shtetërore.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 3,73%, ndërsa për vitin 2015 ka qenë 3,69%. Pra, vihet re rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES	2015					2016				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	3	0	1	0	0	3	1	2	1	0
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	1	0	2	0	0	2	2	2	2	1
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje I fëmijës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
130/a Dhuna në familje	83	67	81	67	19	78	74	87	85	47
Totali	88	67	85	67	19	83	77	91	88	48

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 5,68% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi rritje prej 14,92% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 7%, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur me 31,34% dhe ka rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 152,63% përkundrejt vitit 2015. Një vend të veçantë në grupin e Veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes zë “dhuna në familje”. Vihet re se në vitin 2016 janë regjistruar 78 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”, ndërkohë që në vitin 2015 ky numër ka qenë 83. Janë dërguar në gjykim 74 procedime penale nga ana e organit të prokurorisë në vitin 2016, në vitin 2015 ky tregues ka qenë 67, janë regjistruar 87 të pandehur dhe është ngritur akuzë në gjykatë për 85 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2015 janë regjistruar 81 të pandehur dhe është ngritur akuzë për 67 të tillë, janë dënuar nga gjykata 47 të pandehur për vitin 2016, ndërsa në vitin 2015 janë dënuar 19 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”. Vepra penale e parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë i Kodit Penal, detyrimi i të miturve për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, mbetet ende një problem shqetësues.

LIRIA E BESIMIT

Për këtë grup veprash penale të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2016 nuk janë regjistruar procedime vetëm për veprën penale shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0

VJEDHJA E PASURISË

Nga të dhënat statistikore, rezulton se numri më i madh i procedimeve penale për vitin 2016 vijon të mbetet grupi i veprave penale “vjedhja e pasurisë”.

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 41,53%, ndërsa në vitin 2015 ka qenë 37,67%. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015. Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 2,89% të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2015. Po ashtu, ka ulje të procedimeve penale për “vjedhje me dhunë” prej 35,71% krahasuar me vitin 2015. Ndërkohë, është shënuar ulje me 100% në procedimet penale për “vjedhje me armë” dhe “vjedhja me pasojë vdekjen” nuk ka ndryshim krahasuar me vitin 2015.

VJEDHJA E PASURISË	2015					2016				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 134 Vjedhja	803	191	173	192	64	812	173	182	180	89
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	7	4	1	3	2	3	6	3	6	2
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim.	3	2	3	3	3	0	0	0	0	0
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	53	63	50	65	37	89	69	78	68	48
Neni 137 /a Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 139 Vjedhja me dhunë	28	18	14	22	4	18	7	6	5	7
Neni 140 Vjedhja me armë	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	897	278	242	285	110	923	255	269	259	150

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 2,89% të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi ulje prej 8,27% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 11,15%, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 9,12% dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 36,36% përkundrejt vitit 2015.

MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 2,88%, ndërsa në vitin 2015 është 1,88%. Pra, vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

MASHTRIMET	2015					2016				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 143 Mashtrimi	31	28	21	23	3	39	25	23	23	5
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/2 Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/3 Manipulimi i cmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 144 Mashtrimi në subvencione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 144/a	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	7	5	4	5	4	23	5	18	5	2
Neni 146 Mashtrimi në kredi	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale	6	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërcuesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	45	33	26	28	7	64	30	41	28	8

Shihet një rritje prej 42,22% e numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të mashtrimit të vitit 2016 në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi ulje prej 9% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundëjt këtij totali në vitin 2015 prej 96,15%, i njëjti numër i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,28% përkundëjt vitit 2015.

SHKATERRIMI I PRONËS

Pesha specifike qe ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 1,75%, ndërsa për vitin 2015 ka qenë 2,68%. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

SHKATËRRIMI I PRONËS	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	24	12	11	14	1	13	5	12	9	0
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	25	6	6	6	0	20	2	1	2	1
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbetje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	4	1	1	1	0	1	2	1	0	0
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes	3	8	1	8	7	0	0	0	0	0
Neni 158	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjetës	3	8	1	8	8	1	1	0	5	1
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	0	0	0	0	0	2	0	0	0	2
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv	3	3	4	4	0	0	0	0	0	0
Totali	64	38	24	41	16	39	10	14	16	4

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka ulje në krahasim me vitin 2015, në masën 39% të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të shkatërrimit të pronës. Ndërkaq kemi ulje prej 73,68% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 41,66%, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 60,97% dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 75% përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,04%, për vitin 2015 ka qenë 0,08%. Pra vihet re pothuajse i njëjti nivel për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave	1	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	2	0	2	0	0	1	0	0	0	0

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezultojn se në vitin 2016 ka ulje të dy treguesve të lidhur me procedimin penal. Kështu, në vitin 2015 janë regjistruar 2 procedime penale për këtë grup veprash penale, ndërkohë në vitin 2016 është regjistruar 1 procedim penal, ose 50% më pak. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje me 100% e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,31%, ndërsa për vitin 2015 është 0,37%. Pra vihet re pothuajse i njëjti nivel i këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

V.P. NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 170/c	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170/ç	9	8	9	8	5	7	7	6	6	2
Totali	9	8	9	8	5	7	7	6	6	2

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezultojn se në vitin 2016 ka një ulje prej 22,22% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, në krahasim me vitin 2015. Gjithashtu kemi ulje prej 12,5% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 33,33%, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 25% dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 60% përkundrejt vitit 2015.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 1,21%, ndërsa për vitin 2015 është 3,19%. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	15	0	10	0	0	8	5	6	8	10
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	14	0	3	0	0	12	9	4	9	2
Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	2	0	1	0	0	4	4	4	4	2
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	3	1	1	1	0	2	2	2	2	2
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	3	3	3	3	0	0	0	0	0	0
Totali	76	4	18	4	0	27	21	17	24	16

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 64,47% të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi rritje prej 425% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 5,55%, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 500% dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100% përkundrejt vitit 2015.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,85%, ndërsa për vitin 2015 është 1,67%. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET	2015					2016				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proecd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	9	0	3	0	0	14	5	10	6	0
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	31	7	10	7	0	5	13	3	12	5
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 182/a	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	40	7	13	7	0	19	18	13	18	5

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 52,5% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi rritje prej 157,14% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re i njëjti numër i të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015, rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 157,14 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % përkundrejt vitit 2015.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,22%, ndërsa për vitin 2015 është 0,29%. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	7	5	5	5	1	4	2	2	2	2
Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlerë	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	7	5	5	5	1	5	2	2	2	2

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 28,57% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 60%, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 60% dhe rritje me 100% i të pandehurve të dënuar nga gjykata me vitin 2015.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 3,51%, ndërsa për vitin 2015 është 3,44%. Pra, vihet re rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	43	12	7	18	1	50	13	17	18	1
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	1	0	1	0	0	2	0	1	0	0
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	22	20	14	23	8	19	12	17	14	5
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	16	8	2	10	1	7	4	3	6	0
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	82	40	24	51	10	78	29	38	38	6

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 4,87% të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2015. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015 ka një ulje me 36,66%. Në lidhje me të pandehurit, vërehet rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 58,33%, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 25,49% dhe sërish ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40% përkundrejt vitit 2015.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,27%, ndërsa për vitin 2015 është 0,83%. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 197 Organizimi i llotarive të palejuara	20	26	15	25	9	4	6	4	7	11
Neni 197/a Paracaktimi i rezult. Ne garat sportive	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0

Neni 197/b Shtremberimi i konkurences ne garat sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 198 Venia ne dispozicion e lokaleve per lojra te palejuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	20	26	15	25	9	6	6	4	7	11

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 70% të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit, në krahasim me vitin 2015. Ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015 ka pësuar ulje me 76,92%. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 73,33% dhe ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 72%. Kritje ka numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,22% përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 4,95% sikurse edhe në vitin 2015 ky tregues ka qenë 4,95%. Pra vihet re i njëjti nivel treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

REGJIMI JURIDIK I TOKËS	2015					2016				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 199/a Ndertimi i paligjshem	114	157	111	160	53	108	70	99	68	42
Neni 199/b Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0
Neni 200 Pushtimi i tokës	2	1	1	1	1	0	0	0	0	0
Totali	118	158	112	161	54	110	70	99	69	42

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një ulje prej 6,77% të numrit të procedimeve të regjistruara për Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës, në krahasim me vitin 2015 dhe ulje prej 55,69% të procedimeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 11,6% e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 57,14% dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,22% përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 0,31%, ndërkohë që për vitin 2015 është 0,37%. Pra vihet re pothuajse i njëjti nivel i peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2016.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 201 Ndotja e ajrit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 203 Ndotja e ujërave	3	1	1	1	0	2	0	0	0	1
Neni 204 Peshkim i ndaluar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	6	0	5	0	0	5	0	2	0	0
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 206/b Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	9	1	6	1	0	7	0	2	0	1

Ndërkaq kemi ulje prej 100% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 66,66%, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 100 % dhe kemi 1 të pandehur të dënuar nga gjykata.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHPETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 2,16%, ndërsa për vitin 2015 ka qenë 1,84%. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHPETIT	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	2	2	2	2	0	3	2	2	2	0
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	15	14	19	22	5	13	14	19	19	9
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	8	8	9	9	4	10	6	10	6	1
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrut të punonjësit të policisë së rendit publik	17	15	23	20	0	17	11	18	12	8
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	1	0	1	0	0	3	1	3	1	0
Totali	44	39	54	53	9	48	34	53	40	18

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 ka një rritje prej 9% të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër autoritetit të shtetit” në krahasim me vitin 2015. Ndërkaq kemi ulje prej 12,82% të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 1,85%, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 24,52% dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100% përkundrejt vitit 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike qe ky grup veprash penale zë për vitin 2016 është 2,2%, ndërsa në vitin 2015 pesha e kësaj vepre ka qenë 1,59%. Pra, vihet re ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 248 Shperdorim detyre	31	7	9	12	2	41	9	14	19	2
Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhenies fund te tij	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 70 KPU Shperdorim detyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare	4	1	7	3	0	2	2	1	3	3
Neni 251 Mosmarrja e masave per te nderprere gjendjen e paligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 252 Mbajtja ne burg pa vendim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazise se shtetasve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 254 Shkelja e paprekshmerise se baneses	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtesise se korrespondences	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 256 Shperdorim i kontributeve te dhena nga shteti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 257 Perfitim i paligjshem i interesave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

